

Njoftim i përqendrimit me të cilin Mosburger GmbH, Austri do të fitoj kontrollin e Skatolifiçio La Vegia SPA, Itali

(lënda nr. 08-165/2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 23.12.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është parashtruar njoftim i përqendrimit që është parashtruar në bazë të plotfuqishmërisë së vendimit të gjykatës nga Rexhio Emilia (Reggio Emilia), Itali që miraton blerjen nga Mosburger GmbH, një shoqëri e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Austrisë, me seli në Ketzerger 112, 1232 Vjenë, Austri, numër regjistrimi FN93397z, si blerëse në procedurat e falimentimit të shoqërisë në falimentim Skatolifiçio La Veggia S.p.A (Scatolificio La Veggia S.p.A.), një shoqëri e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Italisë, me seli në Kastellarano (Rexhio Emilia), Via Maestrale numër 6, Itali, numër regjistrimi 305179.

Vendimi është baza për fitimin e kontrollit të pavarur nga Mosburger GmbH nga procedurat e falimentimit në Scatolifiçio La Vegia SPA.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

Mosburger GmbH është e angazhuar kryesisht në prodhimin e paketimit dhe materialeve të paketimit.

Mosburger GmbH kontrollohet plotësisht nga Prinhorn Holding GmbH.

Mosburger GmbH nuk është e pranishme (shoqëri/degë e regjistruar) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi Prinhorn gjeneron të ardhura nga shitja e produkteve nga një shoqëri që është pjesë e Grupit Prinhorn, por grupi nuk është i pranishëm dhe i regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Skatolifiçio La Vegia SPA është e angazhuar kryesisht në prodhimin e pllakave të valëzuara, kartonit të valëzuar dhe kutive të bëra nga dërrasat e valëzuara dhe kartonë të prodhuara në fabrikën e vet

Shoqëria e synuar nuk është pranishme (shoqëri/degë të regjistruar) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, as nuk ka ndonjë qarkullim në tregun relevant në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

17.12.2022

Shkup